REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E SIGURIMIT TË DEPOZITAVE
KËSHILLI DREJTUES

VENDIM

Nr. 32, datë 29.10.2026

MBI
MIRATIMIN E PLANIT TË MENAXHIMIT TË VAZHDIMËSISË SË VEPRIMTARISË NË AGJENCINË SË SIGURIMIT TË DEPOZITAVE

Në bazë dhe në zbatim të nenit 52, pika 1, shkronja "c", të ligjit nr. 53/2014, datë 22.05.2014 "Për sigurimin e depozitave", i ndryshuar, të nenit 8, pika 2, shkronja "k" të Statutit të Agjencisë të miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues nr. 24, datë 31.10.2018, të nenit 5, pika 2, shkronja "a" dhe shkronja "b" të Rregullores "Për administrimin e rreziqeve në Agjencinë e Sigurimit të Depozitave", të miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues nr. 32, datë 23.10.2015, si dhe të nenit 18, pika 2 të Rregullores të Këshillit Drejtues nr. 29, datë 03.11.2014 "Për rregullat dhe procedurat e funksionimit të mbledhjeve të Këshillit Drejtues të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave", dhe me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm, Këshilli Drejtues

V E N D O S I:

1. Të miratojë Planin e menaxhimit të vazhdimësisë së veprimtarisë në Agjencinë e Sigurimit të Depozitave, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Vendimi i Këshillit Drejtues nr. 31, datë 31.10.2022 "Mbi miratimin e planit të vazhdimësisë së veprimtarisë të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave" shfuqizohet.

3. Ngarkohen njësitë organizative të Agjencisë për zbatimin e këtij vendimi.

4. Ngarkohet Sektori i Marrëdhënieve me Publikun për publikimin e këtij vendimi në faqen zyrtare të internetit të Agjencisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Donald Duraj
Kryetar

Shqipe Malaj
Sekretare

Agjencia e Sigurimit të Depozitave
Rruga e Elbasanit, Nr. 317
Tiranë / Albania
t: +355 (4) 2362 989/2347 298 f: +355 (4) 2362 984
e: info@asd.gov.al w: www.asd.gov.al